



BASHKIA MALLAKASTËR
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2608 / 2 prot.

Ballsh, më 22.06.2026

PROCESVERBAL
(I zbardhur nga origjinali)

Për:

Dëgjuesën publike me banorët e Bashkisë Mallakstër, Ballsh.

Njësia Administrative	Data	Ora	Vendi	Struktura
Ballsh	22.06.2026	13:00	Pranë, Pallati Kulturës 'Dino Kalenja'	Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale Grupet e punës për hartimet e planeve vendore

Pjesëmarrja	
Nga Bashkia Mallakastër	
Znj. Etilda Dishaj	Zv/Kryetare
Z. Aleksandër Rama	Drej. Drejtoria Ekonomike dhe Ç. Sociale
Z. Besmir Selami	Drej. N.Sh.P
Z. Fitim Baraj	Drej. Kabineti
Znj. Naime Dervishaj	Drej. Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës
Znj. Rovenë Osmënaj	Koordinator për konsultimin dhe njoftimin e publikut
Nga Këshilli Bashkiak	
Z. Klodjan Shehaj	Kryetar grupi i këshillit
Znj. Zinaida Ahmetaj	Sekretar i këshillit bashkiak

Numri i pjesëmarrësve : ishte 64, 37 burra dhe 27 gra.

Listë prezencë e personave të pranishëm në dëgjuesën publike të zhvilluar më datë 22/06 /2026 në ambientet e pallatit "Dino Kalenja " Ballsh , për hartimin e PBA –së 2027 -2029 ,Planit të Integritetit Bashkia Mallakastër, Planit për barazinë gjinore .

Nr	Emër	Mbiemër	Nr. tel	Firma
1	Majlinda Bard	Bashaj		MB
2	Esmeralda	Ahmetaj		
3	Alketa	Binjaku		
4	Nereida	Hasanaj		
5	Silvana	Mahmutaj	0692404757	
6	Leonora	Xula	0696405055	
7	Fleida	Hoxhaj		
8	Klodian	Shehaj	0694413031	
9	Adrian	Hazizaj	0683212886	
10	Lindita	Ymeraj	0692548517	
11	Amarilda	Masiku	0694600738	
12	Viktor	MAHMUTAJ	0696130501	
13	Erjon Aslanaj	Aslanaj	0692691146	
14	Armon	Vuza	0696708388	
15	Foligjer	Lamej	0693111618	
16	Zharketa	Dumanaku	0692269958	
17	Litoni	Dumauli	0695258166	

18	Elona Xhaferraj			
19	Lejla Hoxha			
20	Edlira Mersaj	0698628157		
21	Erjon Hoxhaj	0692976704		
22	Erjon Selaj	0693353501		
23	Erjon Hoxhaj	069785327		
24	Merita Kamaj	0693478416		
25	Morifona Jakaj			
26	Salushe Haxhiu	0686054554		
27	Mirela Alimeti	0688561546		
28	Leonora Xula			
29	Dallendyshe Elmazi			
30	Natasha Bahicaj			
31	Elton Rudi			
32	Elton Rudi			
33	Gëzim Hoxhaj			
34	Elton Rudi			
35	Pajtim Ziko			
36	Nika Nure			
37	Elton Rudi			
38	Gani Bozha			
39	Erjon Hoxhaj			

40	Lutfan Xhuferraj		0693865929	Xhuferraj
41	Baykush Haxhiu		0693081109	Haxhiu
42	Adem Cigari		0694892006	Cigari
43	Verton Fyzy		0686113840	Fyzy
44	Sidorela Skenderaj			Skenderaj
45	Merita Qallia			Qallia
46	Kristina Zataj			Zataj
47	Klotiche Murgu			Murgu
48	Ajet Haxhi		0693521502	Haxhi
49	Ali Haxhi		0695132242	Haxhi
50	Driton Shehaj		0684607188	Shehaj
51	Estim Hoxhaj		0684004155	Hoxhaj
52	Lige Daci			Daci
53	Ali Shumetu		0696153550	Shumetu
54	ELIANA HAJRA		0692318351	Hajra
55	Enkelinë Bajramaj		0692976704	Bajramaj
56	Enkel HALLI		0682201798	HALLI
57	Shuan Braci		0694736755	Braci
58	Adrian Breda		0682704082	Breda
59	Osmen Fajzi		0692174045	Fajzi
60	Fuat VERBA		0692217646	VERBA
61	Robert Metaj		0693102470	Metaj

62	Prapo	Aslana	0692691144	Prapo
63	Albessio	Holili		Holili
64	Nami K.	Salaj		Salaj
65				
66				
67				
68				

Titujt e Projekt-akteve që konsultohen:

1. Hartimi i dokumentit të parë për P.B.A-në 2027-2029.
2. Plan i Integritetit për Bashkinë Mallakastër.
3. Plani Vendor i veprimit për barazinë Gjimore në Bashkinë Mallakastër.
4. Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve në Bashkinë Mallakastër 2026-2031.

Dëgjuesi e hapi Z. Klodjan Shehaj Kryetari Grupi i Këshillit: - Jemi në këtë dëgjues për të paraqitur PBA 2027-2029 dhe Planet Vendore, sipas njoftimit zyrtar që është bërë 20 ditë më parë, në të cilin keni pasur të shënuar edhe linket përkatëse u gjendeshin materialet që do të konsultohen sot, të cilat do t'i prezantojnë punonjës të administratës.

E merr fjalën Drejt. Drejtoria Ekonomike dhe Ç. Sociale Z. Aleksandër Rama, Bashkia Mallakastër ka përgatitur dokumentin e fazës së parë të programit buxhetor afatmesëm 2027-2029, nga dëgjuesat shpresojmë të marrim kërkesat tuaja për t'i pasqyruar në këtë pba.

Investimet që ka parashikuar bashkia për tre vitet e arshdhme janë:

- Në infrastrukturë rrugore, qytet dhe fshatra;
- Në arsim dhe shkolla;
- Aktivitete rinore
- Bujqësi.

Të ardhurat kryesore të bashkisë janë nga;

- Taksat dhe tarifrat;
- Transfertat e kushtëzuara;
- Transfertat e pakushtëzuara.

Të ardhurat kryesore nga taksat janë listuar 5 më kryesoret;

- Taksa e pasurisë;
- Taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja;
- Taksa për transferimin e pasurisë;
- Taksa për automjet, mjet të përdorur;
- Taksa e zënies së hapësirës publike.

Tarifat ndahen në familjare dhe biznese:

- Tarifat e pastrimit dhe largimit të mbeturinave;
- Tarifa e gjelbërimit;
- Tarifa e ndriçimit
- Tarifat për bizneset me qarkullim mbi 14 milion lekë.

Për 2027-2029:

- 2027 parashikohen 291.704.000 të ardhura;
- 2028 304 milion të ardhura
- 2029 i njëjti nivel të ardhurash sin ë 2028-ën
kurse transfertat e pakushtëzuara nga buxheti i shtetit kanë një rritje.

Transfertat e pakushtëzuara sektoriale janë të dedikuara për:

- Arsimi paashkollor e njëjta vlerë për 2027-2028;
- Administrim i pyjeve;
- Investime për mbrojtjen nga zjarri;

Prioritete :

- Infrastruktura rrugore (asfaltim dhe mirëmbajtje);
- Krijim i hapësirave të gjelbërta;
- Krijim social ekonomik – mbështetja e bizneseve;
- Menaxhimi i mbetjeve urbane- blerje mjeti teknologjikë dhe kontenierësh;
- Rehabilitim i shesheve të naftës;
- Arsim – rikonstruksion shkollash;
- Ujësjiellësa.

Një sër investimesh kryesore janë menduar në rikonstruksionin e rrugëve të Ballshit , të Njësisë Administrative Qendër, dhe Njësive të tjera Administrative si Fratar, Kutë dhe Selitë. Gjithashtu, po investohet në mbrojtjen lumore në fshatin Çorrush dhe kanalizime për sistemin ujitës së fushave të fshatit Hekal nga lumi Vjosa.

Pjesëmarrësit që morrën fjalën dhe diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjen që konsultohet janë si vijon :

Z. Islam Begaj: - Duam vaditjen e tokave në Hekal; Ujë të pijshëm në lagjen Ballaj; vendpushimi dhe stola për të moshuarit.

Z. Aleksandër Rama: - fondi për vaditjen është çelur, siç e tham dhe te prezantimi, që do mundësohet vaditja e tokave të Hekalit nga uji i lumit Vjosa.

Z. Osmën Pashaj: - Në Hekal nuk janë bërë investime; unaza e rrugës në qendër, rruga Çelepias dhe rrugë të tjera.

Z. Fatmir Kalemaj: - Tubacioni i ujit të pijshëm i ndryshkur; Duhet 3 kosha; Nën autostradë 6000 mijë rrënjë ullinj, duam rrugë are të vemi të punojmë dhe të nxjerrim prodhimin; Në fMollaj s'ka rruga një dritë; Qendër shëndetësore e amortizuar; Në Rromës dhe Mollaj duhet pastrami i varrezave.

Z. Viktor Mahmutaj: - Nuk jam dakord me projekt-buxhetin, sepse në asnjë zë nuk kishte ndonjë investim të parashikuar për Njësinë Administrative Aranitas.

Z. Gëzim Goxhaj: - jam që më shumë rëndësi dhe përparësi tu jepni rrugëve që lidhin rrugët kryesore me qendra fshati, që dhe fshatrat të mos braktisen.; të kemi kosha për mbetje, që most ë hidhen mbetjet në përrenj e lumenj. Investimi që u bë për ujin e pijshëm në Poçem-Koilaç, n aka hapur probleme se n aka lën Greshicën pa ujë, sepse më përpara nga ajo depo merrte vetëm Greshica tani merr dhe Koilaçi.

Z. Fuat Verbaj, Klos: - 1. Rruga për parcelat e arave, duam të shtrohet me çakëll; 2. Varrezat e fshatit, pastrimi i ferrave; 3. Shkarje e rrugës kur ikën për Poçem; 4. 60 ha tokë i kam pa rrugë; 5. Probleme me pronën e ullinjve, rrjeti nëntokësor, mbjellje e parcelave me ullinj të paverifikuara.

Z. Kujtim Zeqaj, Dukas: - 1. Rrugë për parcelat; 2. Rrugë në fshat; 3. Kur u shtrua rruga kryesore nuk u vu tubacion dhe rruga po dëmtohet.

E. Besmir Selami: - Jemi 42 fshatra, e kuptoj shqetësimin tuaj, por me fuqinë punëtore dhe mjetet që kemi, po punojmë për ditë dhe nuk kemi mundur t'i mbyllim të gjitha këto punë. Për çdo rast jemi duke punuar. Përpiqemi t'u japim zgjidhje menjëherë sipas përparësisë dhe mundësive. Kemi lënë rrugët kryesore të fshatrave, tani po kërkojmë të lagjeve dhe të arave.

Z. Islam Begaj: Pse nuk planifikoni në buxhet blerjen e mjeteve të tjera për pastrim dhe mirëmbajtje rrugësh?

Z. Fitim Baraj: - B.M. i ka dhënë prioritet punës për rrugët e parcelave, kaluam dhe fondin për blerjen e një buldozeri, por s'u realizua blerja për arsye teknike të mjetit.

Kalojmë te prezantimi i **Plani të Integritetit**:

Z. Fitim Baraj: - Bashkia Mallakastër e konsideron integritetin si një nga vlerat themelore të qeverisjes së mirë dhe si një element thelbësor për garantimin e transparencës, forcimin e llogaridhënies, parandalimin e korrupsionit dhe rritjen e besimit të qytetarëve ndaj institucioneve publike.

Të vetëdijshëm për sfidat me të cilat përballlet qeverisja vendore dhe për përgjegjësinë që mbartim në ofrimin e shërbimeve publike me standarde të larta profesionale, jemi angazhuar në hartimin e këtij Plani të Integritetit me synimin për të forcuar performancën institucionale, për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve ndaj qytetarëve dhe për të konsoliduar kulturën e integritetit në administratën e Bashkisë Mallakastër.

Plani i Integritetit është rezultat i një procesi gjithëpërfshirës vetëvlerësimi, të realizuar me pjesëmarrjen aktive të strukturave administrative të bashkisë dhe të koordinuar nga Grupi i Punës i ngritur për këtë qëllim. Gjatë këtij procesi u analizuan proceset kryesore të punës, me fokus të veçantë në identifikimin e fushave më të ekspozuara ndaj risqeve të integritetit, praktikave korruptive dhe parregullsive administrative.

Në përfundim të procesit të vlerësimit u identifikuan dhe u analizuan risqet e integritetit në të gjitha fushat e veprimtarisë së bashkisë, duke përcaktuar masat konkrete dhe mekanizmat e nevojshëm për menaxhimin dhe minimizimin e tyre.

Nëpërmjet zbatimit të objektivave dhe masave të parashikuara në këtë plan, Bashkia Mallakastër angazhohet të:

- Përmirësojë dhe forcojë kuadrin e brendshëm rregullator në fushën e etikës dhe integritetit;
- Zhvillojë kapacitetet institucionale dhe profesionale të burimeve njerëzore për identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin efektiv të risqeve të integritetit;
- Rrisë transparencën, llogaridhënien dhe pjesëmarrjen qytetare në proceset vendimmarrëse;
- Forcojë mekanizmat e kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit të riskut në të gjitha proceset kryesore të punës;
- Promovojë kulturën e integritetit, etikës profesionale dhe përgjegjshmërisë në të gjitha nivelet e administratës bashkiake.

Bashkia Mallakastër angazhohet të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e Planit të Integritetit dhe të sigurojë përfshirjen aktive të të gjitha strukturave përgjegjëse në realizimin e objektivave dhe masave të përcaktuara në të.

Në këtë kuadër, shprehim përkushtimin tonë të plotë për zbatimin e këtij dokumenti strategjik, i cili do të udhëheqë përpjekjet institucionale për forcimin e integritetit, rritjen e transparencës, përmirësimin e qeverisjes vendore dhe parandalimin e korrupsionit gjatë periudhës 2026–2029.

Kalojmë te prezantimi i **Planit të Barazisë Gjinore**:

Znj. Naime Dervishaj: Të nderuar përfaqësues të institucioneve dhe pjesëmarrës të pranishëm,

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 „Për vetëqeverisjen vendore”, ndryshuar, Ligji nr.9970 datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore, në përmbushje të misionit të vetëqeverisjes vendore për një qeverisje të efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve, Bashkia Mallakastër ka iniciuar “ Miratimin e Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore në Bashkinë Mallakastër 2026-2031”.

Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore në Bashkinë Mallakastër për periudhën 2026–2031, është një dokument strategjik që synon të garantojë mundësi të barabarta për gratë dhe burrat në çdo fushë të jetës shoqërore, ekonomike dhe institucionale.

Qëllimi kryesor i këtij plani është garantimi i mundësive dhe trajtimit të barabartë mes grave dhe burrave, si dhe eliminimi i diskriminimit dhe dhunës me bazë gjinore.

Ky plan është hartuar në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe politikat kombëtare për barazinë gjinore, me synimin për të adresuar sfidat ekzistuese dhe për të krijuar një mjedis më gjithëpërfshirës për të gjithë qytetarët.

Dokumenti fokusohet në disa fusha kryesore, si:

- fuqizimi ekonomik dhe rritja e punësimit të grave;
- përfaqësimi i barabartë në vendimmarrje dhe pozicione drejtuese;
- përmirësimi i aksesit në shërbimet sociale, shëndetësore dhe arsimore;
- parandalimi dhe lufta kundër dhunës me bazë gjinore;
- ndërgjegjësimi publik dhe eliminimi i stereotipeve diskriminuese.

Rëndësia e Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore:

- **Rritje e punësimit:** Aktivizon forcën e punës të grave.
- **Luftë kundër varfërisë:** Fuqizimi ekonomik i grave ul drejtpërdrejt nivelet e varfërisë në komunitet.
- **Përdorim i drejtë i fondeve:** Integron buxhetimin me bazë gjinore, duke siguruar që paratë publike t'i shërbejnë njëloj burrave dhe grave.
- **Përfaqësim i balancuar:** Siguron që zëri i grave të dëgjohet në pozicionet drejtuese dhe në hartimin e politikave.
- **Shërbime publike më të mira:** Shërbimet (si çerdhet, kopshtet, ndriçimi publik) dizajnohen duke marrë parasysh nevojat e ndryshme të të dyja gjinive.
- **Transparencë dhe llogaridhënie:** Institucionet monitorohen me tregues të qartë se sa po punojnë për barazinë.
- **Lufta ndaj dhunës:** Forcon mekanizmat vendorë dhe qendrorë për parandalimin e dhunës në familje dhe mbështetjen e viktimave.
- **Eliminimi i stereotipeve:** Edukon brezat e rinj dhe komunitetin kundër roleve tradicionale kufizuese dhe diskriminimit.
- **Drejtësi sociale:** Ndërton një shoqëri ku profesioni, paga dhe mundësitë nuk kushtëzohen nga gjinia.
- **Detyrim ligjor:** Përmbush kërkesat e kuadrit ligjor vendas për barazinë gjinore.
- **Integrimi Evropian:** Plotëson kriteret e Bashkimit Evropian
- **Qasje në fonde:** Shumë donatorë ndërkombëtarë dhe fonde të BE-së e kanë kusht ekzistencën e një plani gjinor për të dhënë grante.

Miratimi i këtij plani për pesë vitet e ardhshme dëshmon angazhimin e Bashkisë Mallakastër për një zhvillim të drejtë, të qëndrueshëm, gjithëpërfshirës, në edukimin e brezave të rinj, vlersimin e punës rurale, si dhe prinderimin e përbashkët, duke lehtësuar ngarkesën emocionale dhe fizike të grave.

Për secilin objektiv janë përcaktuar aktivitete konkrete, institucionet përgjegjëse, afatet e zbatimit dhe treguesit e matjes së rezultateve, duke siguruar që angazhimet të shoqërohen me veprime të prekshme dhe të matshme.

Zbatimi i këtij plani pritet të kontribuojë në rritjen e punësimit, përmirësimin e shërbimeve publike, forcimin e drejtësisë sociale dhe rritjen e përfaqësimit të grave në jetën publike dhe vendimmarrëse.

Kjo dëgjese publike është një mundësi e rëndësishme për të dëgjuar sugjerimet, komentet dhe propozimet tuaja, në mënyrë që dokumenti përfundimtar të reflektojë sa më mirë nevojat dhe prioritetet e komunitetit tonë.

Ju falënderojmë për pjesëmarrjen dhe kontributin tuaj në këtë proces.

Kalojmë te prezantimi i Planit Vendot për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve

Z. Besmir Selami: Plani Lokal i Menaxhimit të Mbetjeve (PLMM) i Bashkisë Mallakastër është një dokument strategjik 5-vjeçar, i hartuar për të përmirësuar sistemin e menaxhimit të mbetjeve në territorin e bashkisë. Ai synon të garantojë mbrojtjen e mjedisit, përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve dhe nxitjen e ekonomisë qarkulluese, duke e konsideruar mbetjen jo vetëm si problem mjedisor, por edhe si burim me vlerë ekonomike.

Kuadri ligjor: Plani mbështetet në legjislacionin shqiptar për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe është në përputhje me politikat dhe direktivat e Bashkimit European. Ai harmonizohet me Strategjinë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve 2020–2035 dhe me objektivat kombëtare për zhvillim të qëndrueshëm.

Objektivat kryesore, plani synon:

- Përmirësimin e sistemit të menaxhimit të mbetjeve në përputhje me kërkesat ligjore.
- Harmonizimin dhe forcimin e kuadrit institucional.
- Sigurimin e financimit të qëndrueshëm për shërbimet e pastrimit dhe menaxhimit të mbetjeve.
- Rritjen e ndërgjegjësimit dhe pjesëmarrjes së qytetarëve.
- Përmirësimin e instrumenteve ligjore, institucionale dhe financiare.

Fusha e veprimit, plani përfshin të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Mallakastër dhe mbulon:

- Pastrimin e rrugëve dhe hapësirave publike.
- Grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve.
- Trajtimin dhe depozitimin e tyre.
- Menaxhimin e mbetjeve shtëpiake, organike, inerte, elektronike dhe të riciklueshme.
- Strategjia dhe Plani Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve

Menaxhimi i mbetjeve përbën një nga sfidat më të rëndësishme mjedisore dhe sociale në Shqipëri. Për këtë arsye, Strategjia dhe Plan i Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve 2020–2035 janë hartuar për të krijuar një sistem modern, të qëndrueshëm dhe në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian. Dokumenti është përgatitur nën kujdesin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe është miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 418, datë 27.05.2020.

Objektivi kryesor i strategjisë është ofrimi i zgjidhjeve praktike për problemet ekzistuese të menaxhimit të mbetjeve, zbatimi i plotë i kuadrit ligjor në fuqi dhe përmbushja e detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni evropian, duke përfshirë objektivat për ekonominë qarkulluese.

Strategjia mbështetet në pesë qëllime themelore:

- Përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet e planifikimit.
- Harmonizimin dhe forcimin e kuadrit ligjor për menaxhimin e mbetjeve.
- Sigurimin e financimit të qëndrueshëm për shërbimet e menaxhimit të mbetjeve.
- Rritjen e kapaciteteve njerëzore, ndërgjegjësimin dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset e menaxhimit të mbetjeve.
- Përmirësimin e instrumenteve ligjore, institucionale dhe financiare për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme.

Zbatimi i kësaj strategjie synon të reduktojë ndotjen e mjedisit, të rrisë normat e riciklimit dhe ripërdorimit, si dhe të minimizojë sasinë e mbetjeve që përfundojnë në venddepozitime. Në të njëjtën kohë, ajo promovon konceptin e ekonomisë qarkulluese, ku mbetjet shihen si burim me vlerë ekonomike dhe jo thjesht si problem mjedisor.

Në përfundim, Strategjia dhe Plan i Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve përfaqësojnë një instrument të rëndësishëm për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit, duke synuar mbrojtjen e mjedisit, përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve dhe afrimin e Shqipërisë me standardet evropiane në fushën e menaxhimit të mbetjeve.

Gjendja e mbetjeve

Sipas të dhënave të paraqitura:

- Mbetjet organike përbëjnë mbi 45% të totalit.
- Mbetjet e riciklueshme (letër, plastikë, qelq dhe metal) përbëjnë rreth 30%.
- Mbetjet e përziera përbëjnë afërsisht 25%.

Kjo strukturë tregon potencial të konsiderueshëm për riciklim dhe kompostim.

Plan i veprimit 2026–2031, parashikon:

- Zgjerimin e shërbimit të grumbullimit në të gjithë territorin e bashkisë.
- Rritjen e numrit të kontejnerëve dhe përmirësimin e mjeteve të transportit.
- Ndarjen e mbetjeve në burim.
- Nxitjen e riciklimit dhe kompostimit, veçanërisht në zonat rurale.
- Reduktimin e sasisë së mbetjeve që përfundojnë në venddepozitime.
- Edukimin dhe ndërgjegjësimin e komunitetit për mbrojtjen e mjedisit.

- Financimi dhe monitorimi

Zbatimi i planit do të mbështetet nga Bashkisë Mallakastër dhe Ndërmarrja e Shërbimet Publike. Monitorimi do të kryhet në mënyrë periodike përmes treguesve të performancës, duke mundësuar identifikimin e problemeve dhe marrjen e masave korrigjuese kur është e nevojshme.

Përfundim

Plani Lokal i Menaxhimit të Mbetjeve për Bashkinë Mallakastër përfaqëson një instrument të rëndësishëm për zhvillimin e qëndrueshëm të territorit. Përmes përmirësimit të shërbimeve, rritjes së riciklimit, forcimit të infrastrukturës dhe ndërgjegjësimit të qytetarëve, ai synon të krijojë një mjedis më të pastër, më të sigurt dhe më të qëndrueshëm për komunitetin.

Znj. Etilda Dishaj: - dëgjesat publike na shërbejnë për të qen sa më afër me ju në kërkesat dhe problem tuaja, dhe të jemi në gjendje t'ju shërbejmë për çdo process, ashtu siç ishte azhornimi, sistemi i kullimit, investimet në arsim, etj.

Mbyll dëgjesën publike kryetari i Këshillit Bashkiak të Mallakastrës Z. Nexhmi Sulaj;

- keni një afat 5 ditor për të paraqitur ndonjë kërkesë ose ankesë tjetër në lidhje me çfarë u prezantua sot këtu, qoftë me shkrim qoftë me postë elektronike, sit e faqja e bashkisë edhe e këshillit.

- çdo kërkesë do të shqyrtohet nga administrata e bashkisë, por edhe në mbledhjen e radhës së këshillit.

Faleminderit!



MBAJTËS PROCESVERBALI

Koordinator për konsultimin dhe
njoftimin e publikut

Rovena Osmënaj

Sekretar Këshillit

Zinaida Ahmetaj